

# **Psilla e dardhës në disa kultivar të dardhës të kultivuar në komunën e Malishevës dhe masat për menaxhimin e dëmtuesit**

## **ABSTRAKT**

Dëmtuesit të cilët shfaqen në dardhë janë të shumtë, prej të cilëve dëme të konsiderueshme shkakton edhe psilla e dardhës (*Psylla* spp.). Qëllimi i këtij punimi ka qenë: (i) Hulumtimi i përhapjes së psillës (*Psylla pyri*) në kulturën e dardhës në një plantacion me dardhë në komunën e Malishevës, (ii) Hulumtimine dinamikës dhe nivelit të populacioneve të psillës së dardhës te disa kultivar të dardhës, si dhe (iii) Masat për menaxhimin e këtij dëmtuesi.

Për nevojat e hulumtimit të psilla pyri në kulturën e dardhes, eksperimenti është vendosur në fshatin Lladrovç në komunën e Malisheves. Në eksperiment janë përfshirë kater kultivarë të dardhes (Conferenca, Abate fetel, Santa Maria dhe Carmen), ndërkaq eksperimenti është vendosur sipas metodës së blloqeve të randomizuara në tri përsëritje.

Sipas metodës së rastit në secilën përsëritje janë monitoruar respektivisht kontrolluar nga 10 gjethe të dardhes prej të cilave janë marrë mostra për analizë në interval një javore. Mostrat e marra janë dërguar në laboratorin e mbrojtjes së bimëve në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë, për identifikimin e dëmtuesit. Për identifikimin e këtij dëmtuesi janë përdorë çelësa dhe atlase të ndryshëm entomologjike. Gjatë hulumtimeve njëvjeçare, në lidhje me paraqitjen e psylla pyri të kultivarët e hulumtuar të dardhes janë konstatuar të gjitha fazat e zhvillimit të këtij dëmtuesi (Veza, larva, dhe imago).

Sa i përket prekjes së kultivarëve të hulumtuar nga psylla pyri si më i ndjeshëm është konstatuar të jetë kultivari Carmen ku numri i individëve të konstatuar pa marrë parasysh fazën e zhvillimit të këtij dëmtuesi ka qenë 818 ndërsa më së paku ka qenë i prekur kultivari Santa Maria ku numri i këtij dëmtuesi ishte 607. Përmes analizës së variansës dhe testimit me LSD, dallime statistikore të niveleve të ndryshme të sinjifikacionit janë konstatuar në mes të kultivarëve të dardhes të përfshira në eksperiment, sa i përket prekjes nga *Psylla pyri*.

Niveli i dëmeve gjatë këtyre hulumtimeve ka qenë i ndryshme te kultivarët e dardhës, kështu niveli më i lartë i shkallës së dëmeve në gjethe ka qenë te kultivari Carmen. Në kuadër të Mbrojtjes së integruar duhet ndërmarrë masat mbrojtëse ku përparësi duhet dhënë masave të tjera, sidomos atyre preventive sikurse janë: fidanët e shëndoshë, mbjellja e kultivarëve të

qëndrueshëm apo rezistent ndaj dëmtuesit, masat agroteknike të rregullta etj. dhe përdorimin e preparateve kimike si alternativë të fundit.